




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës Jugore
Opstina J.Mitrovica – Municipality of S. Mitrovica

Drejtoria e Inspektionit



03.07.2025

RAPORTI I PUNËS I DREJTORISË SË INSPEKSIONIT

Janar-Qershor
2025



Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugore
Opstina J.Mitrovica – Municipality of S. Mitrovica

Drejtoria e Inspekcioni

REFERENCË	01-052/01-0039123/28
PËR/ZA/TO:	z. Bedri Hamza – Kryetar i Komunës së Mitrovicës
CC:	z. Valon Hetemi – Shef i Kabinetit
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Znj.Leonida Sherifi – Zytare Administrative
NGA/OD/FROM:	z. Valon Brahimi – Drejtor i Drejtorisë së Inspekcioni
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raporti i Punës i Drejtorisë së Inspekcioni për periudhën: Janar – Qershor 2025
DATA/DATUM/DATE:	03.07.2025



Raporti i punës së Drejtorisë e Inspekcioni, bazohet në kompetencat dhe përgjegjësit ligjore që dalin nga dispozitat ligjore si: Ligji nr. 03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligji nr. 08/L-067 për Inspektim, Ligji për Inspektoratin e Tregut 03/L-181, Ligjin 04/L-186 për Plotësim Ndryshimin e Ligjit 03/L-181, Ligji 04/L- 175 për Inspektoratin e Ujrave, Natyrës, Planifikimit dhe të Ndërtimit, Ligjit nr. 04/L-179 Për Transportin Rrugor, Statutin e K.K. Mitrovicë e Jugut si dhe Rregulloren nr. 02/2012 dhe nr. 01/2017 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale dhe akte tjera ligjore.

PËRMBLEDHJE

Raporti i punës së Drejtorisë e Inspekcioni, paraqet përmbledhje të punëve, aktiviteteve dhe veprimeve të ndërmara në zbatim të dispozitave relevante ligjore dhe nënligjore, Planit të Punës dhe në trajtim të kërkesave të parashtruara institucionit tonë dhe rasteve ad-hoc të paraqitura.

Në ushtrimin e funksionit, bazuar në kompetencat dhe përgjegjësitë juridike, Drejtoria e Inspekcioni konsideron se ka përmbushur planin vjetor të punës të vitit 2025 për periudhën Janar-Qershor.

1. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

- Inspektimi i veprimtarive-subjekteve afariste;
- Përgjigja në kërkesa zyrtare;
- Trajtimi i rasteve ad-hoc;
- Perpilimi i procesverbaleve, nxjerrja e vendimeve dhe akteve tjera dhe ekzekutimit i tyre;
- Paraqitja e shkeljeve Kundërvajtëse dhe Kallëzime Penale.

Aktivitetet në fjalë zërthehen në aktivitete dhe veprime konkrete të cilat realizohen në bazë të planit ditor dinamik të Drejtorisë së Inspektionit.

2. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

2.1. Sektori i Tregut

- Kontrolla inspektuese me qëllim të Pajës me PELQIME për plotësim e kushteve Minimale- Teknike konform U.A 2005/12;
- Mbrojtjen e të drejtës së konsumatorit;
- Kontrollat inspektuese për vendosjen e çmimeve, mbajtësen dhe azhuritetin e librave dhe evidencës në subjekte afariste;
- Kontrollimi i dhënies së tiketave shitëse, respektimin e orarit të punës, kontrollimin e deklarave të mallrave;
- Udhëzimet teknike dhe garancionet e mallrave si dhe saktësia e dokumentacionit përcjellës, etj;
- Inspektimi i kushteve teknike të subjekteve afariste tregtare që marrin me shumicë dhe pakicë dhe subjektet shërbyese, etj;

2.2. Sektori i Shërbimeve Komunale

- Inspektime për shfrytëzimin e hapësirave publike;
- Inspektime për gjendjen e pastërtisë në hapësirat publike;
- Kontrolla për vendosje konform ligjeve për mbishkrimet, panot dhe tabelat reklamuese;
- Inspektime tjera nga fusha e përgjegjësisë.

2.3. Sektori i Ndërtimit

- Kontrolla inspektuese në parandalim të ndërtimeve pa leje;
- Kontrollimi i lejeve të ndërtimit dhe certifikatën përdorimit;
- Rrënim i ndërtimeve pa leje;
- Inspektimi dhe leshimi i certifikat të përdorimit;
- Mbrojtja e objekteve të vjetra;

2.4. Sektori i Transportit Rrugor

- Inspektimi dhe kontrollimi i operatorëve të transportit rrugor urban dhe urban-periferik;
- Inspektimi dhe kontrollimi i të gjitha automjeteve të transportit rrugor taksit;
- Inspektimi dhe kontrollimi i të gjitha automjetet dhe ekuipazhin e transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave , objektet tjera afariste , dokumentacionin dhe evidencat që i takojnë

- transportit rrugor brenda territorit të Komunës:
- Përgjigja në kërkesa zyrtare dhe kontrolla inspektuese ad-hoc etj.

3. STATISTIKAT

Më poshtë janë paraqitur në mënyrë tabelare aktivitetet, masat dhe veprimet që janë ndërmarr gjatë punës së Drejtorisë së Inspekcionit për periudhën Janar-Qershor 2025, të përmbledhura në të dhëna numerike.

Aktivitete, masa dhe veprime.	Njësia
Inspektime me procesverbal	638
Aktvendime për eliminim të parregullsive	70
Aktvendim për marrjen e pëlqimit për Taxi	37
Përkrahje të automjeteve taxi nga qarkullimi për 48 orë	/
Biznese të regjistruara për here të pare	69
Shuma e inkasuar nga gjobat me Rregullore Kounale (7)	/
Mjetet e inkasuara nga Komisioni për kushte minimale teknike	/
Vlera e produkteve të ndaluara	/
Subjektet të paisura me pëlqime	66
Produktet të ndaluara nga shitja deri në eliminimin e parregullsive	/
Vlera e mallrave të asgjësuar	/
Kërkesa nga Palet	48
Kërkesa për Gjykatë	6
Gjohë mandatore	6
Vendime për ekzekutim	6
Mbyllje e lokalit	3
Produktet e inspektuara me dokumenta teknike - garancione	69
Produktet e inspektuara ushqimore dhe jo ushqimore	513
Aplikime për pëlqime	/
Malli i ndaluar nga shitja	4557.57 €
Me shtojca 1.2.3.4/A.4/B.4/C.4/D.4/E.4/F.UA. MMPH nr. 05/2017	168
Gjohat Mandatore në bazë të UA nr. 20/2013	3000.00 Euro
Objekt banesor afarist	7
Konzervime të objekteve të ndërtimit	9
Kallëzime penal	11
Aktvendime për ndërprerje të punëve	41
Objekt individual	6
Objekt kolektiv	5
Leje për ndërtim nga DSHPI	10

Leje Ndërtimore nga DPU	18
Aktivendim për rrënim	8
Lëndë në procedurë	101
Lëndë të përmbaruara	158
Totali i lëndëve	259

PËRFUNDIM

Raporti i Punës i Drejtorisë së Inspektionit për periudhën Janar-Qershor 2025 është dokument i rëndësishëm që veçantë ngase ofron informacione të rëndësishme mbi punën, aktivitetin dhe angazhimin e kësaj drejtorie në zbatim të ligjit, mbajtje të rendit komunal dhe realizim të planit vjetor të punës. Në kuadër të ushtrimit të mandatit ligjor, Drejtoria e Inspektionit ka hasur në një vargë vështirësish dhe probleme si ato të natyrës njerëzore po ashtu edhe teknike, të cilat janë tejkaluar me suksesë, falë profesionalizimit dhe vullnetit të lartë të treguar nga menaxhmenti dhe stafi profesional i kësaj drejtorie.

Me respekt!